

ARTIKULLI #9

UNIVERSITETI I IOWA-S MBËSHKET BORDET INDUSTRIALE NË UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS

Për të Nxitur Bashkëpunimin Akademi-Industri për Sukses në të Ardhmën

OCTOBER 15, 2023

Për më shumë foto mbi këtë artikull, shkoni në link:

<https://drive.google.com/drive/folders/1ZALHz0bHQ-7QIOtB9MaXKQf6iokXjL2A>

Në ndjekje të forcimit të arsimit të lartë dhe promovimit të partneriteteve kuptimplotë akademi-industri, aktiviteti i financuar nga USAID Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë bashkon forcat me tri universitetet publike në Kosovë për të punuar me dhe fuqizuar Bordet Industriale për vitin akademik 2023-2024. Ky aktivitet është mbështetur nga USAID dhe i zbatuar nga Universiteti i Iowa në partneritet me Universitetin Shtetëror të Iowa dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC).

Takimet e Bordeve Industriale, të organizuara nga ekipet administrative të fakulteteve, ndodhin disa herë gjatë vitit dhe shërbejnë si urë mes akademisë dhe industrisë, duke ftuar përfaqësues të fuqisë punëtore për të ofruar njohuri esenciale për rolin e universiteteve në përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Ky bashkëpunim rezulton me një skenar të dobishëm reciprok: udhëheqësit e sektorit privat ndajnë kompetencat dhe aftësitë që kërkohen nga punëmarrësit e tyre të ardhshëm, të cilët diplomojnë nga këto institucione, dhe universitetet adaptojnë kurrikulat e tyre, metodat e mësimdhënies, dhe shërbimet për të prodhuar të diplomuar të cilët mishërojnë këto kompetenca dhe aftësi.



Figura 1: Anëtarët e Bordit vizitojnë Institutin për Zhvillim të Bujqësisë, i cili ka mirëpritur takimin e Bordit Industrial të Fakultetit të Bujqësisë dhe Shkencave Shtazore të Universitetit të Prishtinës.

Deri më tani, projekti ka mbështetur takimet e Bordeve Industriale si për sektorët e bujqësisë, ashtu edhe ato të teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve (TIK) në Shtator dhe Tetor 2023. Ekipi i projektit nga Universiteti i Ilova-s ka punuar ngushtë me dekanët e fakulteteve dhe qendrat e karrierës së universiteteve partnere për të lehtësuar këto takime. Këto mbledhje shërbyen si platformë për të koordinuar bashkëpunimin e ardhshëm dhe për të forcuar përkushtimin nga përfaqësuesit e bizneseve pjesëmarrëse. Shumë kompani të sektorit privat kanë dalë vullnetare për të mirëpritur takimet e ardhshme, duke nxitur kështu një atmosferë bashkëpunimi dhe përgjegjësie të përbashkët. Në fakt, derisa takimet inauguruese të Bordeve Industriale për vitin 2023 kanë ndodhur në kampuset universitare, disa prej takimeve pasuese të tetorit u mirëpritën nga kompani të jashtme të ftuara.

Në deklaratat e mëposhtme, disa prej pjesëmarrësve të takimeve të fundit të Bordeve Industriale shprehin shpresat e tyre dhe inkurajojnë kompanitë dhe organizatat e tjera të bashkohen në këto përpjekje bashkëpunimi për të shtyrë përpara zhvillimin e sektorëve të tyre përkatës:

“Meqë organizata jonë synon të forcoj sektorin e TIK dhe të nxis mundësi për rritje në këtë fushë, ne vazhdimisht jemi përpjekur të mbështesim bordet industriale të universiteteve publike dhe fakulteteve brenda sektorit të TIK. Me mbështetjen e shtuar nga Konsortiumi i Ilova-s këtë vit dhe përkushtimin e demonstruar të UP-së për t'i shtyrë gjërat në nivelin tjetër me bordet industriale, unë jam optimiste që do të kemi ndikim më të madh në formësimin e programeve esenciale të studimit dhe mundësi për zhvillim të karrierës për studentët e TIK në Kosovë.”

Inkurajoj fuqishëm që më shumë partnerë të sektorit privat të marrin pjesë në takimet pasuese të bordeve industriale, dhe nuk mund mjaftueshëm të theksoj ndikimin e rëndësishëm që ai bashkëpunim do të ketë në nxitjen e suksesit si për studentët, ashtu edhe për kompanitë.” - Vjollca Cavolli, Drejtoreshë Ekzekutive në Asociacionin Kosovar të TIK, STIKK



Figura 2: Takimi i Bordit Industrial për Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës. Takimi u mirëprit nga anëtarë i bordit: STIKK (Asociacioni Kosovar i TIK në Prishtina Tech Park)

“Jam e gëzuar që jam pjesë e Bordit Industrial për Fakultetin e Agrobiznesit në Universitetin e Pejës. Është vërtetë shpërblyese të kemi mundësinë të kontribuojmë në hartimin dhe ofrimin e arsimit për punëmarrësit tanë të ardhshëm dhe profesionistëve të bujqësisë. Është inspiruese të jemi dëshmitarë të përpjekjeve bashkëpunuese mes sektorit privat dhe universiteteve publike në Prishtinë, Pejë dhe Prizren, kur ato po bashkojnë forcat dhe sinergjitë për të mbështetur njëra tjetrën, e gjithë kjo për të mirën më të madhe të prodhimit dhe mundësive bujqësore në Kosovë. Kam shpresë që më shumë biznese do të njohin rëndësinë e këtyre takimeve të bordeve dhe në mënyrë aktive të kontribuojnë më njohuritë e tyre të vlefshme për mbledhjet e ardhshme.” - Valentina Lajqi, Menaxhere e Cilësisë në Boost Berries



Figura 3: Takimi i Bordit Industrial i mbajtur në Fakultetin e Agrobiznesit, Universiteti i Pejës

Këto takime të Bordeve Industriale janë mundësi të vlefshme për të prezantuar dhe marr informata dhe njohuri për një gamë të gjerë të aktiviteteve të cilat USAID dhe Konsortiumi i Iowa, i përbërë nga Universiteti i Iowa, Universiteti Shtetëror i Iowa, dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) kanë dizajnuar për të forcuar universitetet publike të zgjedhura përmes këtij projekti. Gama e bashkëpunimit në këto takime përfshin vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, reformën e kurrikulës, mundësi të mësimxënies me përvojë, dhe iniciativa të kërkimit të aplikuar. Kjo përpjekje bashkëpunimi, e cila sjell së bashku universitetet, sektorin privat, dhe iniciativat ndërkombëtare zhvillimore, është dëshmi e dedikimit të të gjithë të përfshirëve për të fuqizuar studentët me aftësitë esenciale, njohuritë, dhe përvojat e kërkuara për të lulëzuar në tregun e punës gjithmonë e në zhvillim.